

2019 - 2031

**HIPOTEZAT E PROJEKSIONEVE
TË PËRDITËSUARA TË
POPULLSISË**

Hipotezat e Projeksioneve të Përditësuara të Popullsisë 2019 – 2031

Hipotezat e Lindshmërisë

Për ndërtimin e hipotezave të lindshmërisë duhen pasur parasysh tre tregues. Këta tregues janë indeksi sintetik i fekonditetit (ISF), moshë mesatare në lindje (MML) dhe raporti gjinor në lindje.

Moshë mesatare në lindje në Shqipëri ka shfaqur një rritje konstante lineare me rreth 0,27 çdo vit, përgjatë periudhës nga viti 2014 deri në vitin 2018. Gjithashtu, ky tregues ka mbajtur të njëjtin ritëm rritjeje pavarësisht rritjes apo zvogëlimit të indeksit sintetik të fekonditetit. Për këtë arsye, është menduar që MML do të vazhdojë rritjen lineare me të njëjtin ritëm deri në vitin 2031, kur pritet të arrijë në 31,5 vite. Kjo hipotezë do të jetë e njëjtë si për hipotezën e lindshmërisë së ulët, ashtu edhe për atë të mesme dhe atë të lartë.

Raporti gjinor në lindje në Shqipëri është mbi nivelin e tij natyror, me rreth 108 bebe djem për çdo 100 bebe vajza. Për këtë tregues është supozuar që ai do të zvogëlohet në mënyrë graduale dhe do të arrijë nivelin natyror prej 105 djem për çdo 100 vajza në vitin 2031. Zvogëlimi i këtij treguesi do të jetë i njëjtë në të tre variantet.

Lindshmëria e lartë (ISF e lartë)

Si shembull i normave qëndrueshëm të larta të lindshmërisë shërbejnë Vendet Skandinave (Danimarka, Norvegjia dhe Suedia). Sipas të dhënave më të fundit të Eurostat, indeksi sintetik i fekonditetit në këto vende, me përjashtime të rralla, është luhatur ndërmjet 1,65 dhe 2,0 fëmijë për grua në moshë riprodhuese përgjatë gjithë periudhës 2001 – 2016. Prandaj, duke marrë si shembull përvojën e këtyre vendeve, hipoteza e ISF të lartë është projektuar me anë të një funksioni logaritmik që të arrijë nga 1,37 lindje për grua në vitin 2018 në 1,8 lindje për grua në vitin 2031.

Lindshmëria e mesme (ISF e mesme)


Në rastin e lindshmërisë së mesme, ISF është projektuar të arrijë nga 1,37 lindje për grua në vitin 2018 në 1,5 lindje për grua në vitin 2031, gjithmonë duke ndjekur një funksion logaritmik. Ky nivel përkon me mesataren e periudhës 2015 – 2018, vite gjatë të cilave ISF ka qenë nën nivelin 1,7. Kjo hipotezë nënkupton që gratë në Shqipëri do të rekuperojnë lindjet, pasi mendohet që gjatë pesë viteve paraardhëse ato t'i kenë shtyrë ato. Ky fenomen i shtyrjes dhe më pas rekuperimit të lindjeve është i njohur dhe mbështetet për më tepër edhe nga rritja konstante e moshës mesatare në lindje.

Lindshmëria e ulët (ISF e ulët)

Në rastin e lindshmërisë së ulët, ISF është projektuar me anë të një funksioni logaritmik të arrijë nga 1,37 lindje për grua në vitin 2018 në 1,2 lindje për grua në vitin 2031. Niveli prej 1,2 lindjesh për grua është marrë nga përvoja e mëparshme e vendeve të Evropës Lindore. Në këto vende, gjatë viteve 1990 dhe 2000, indeksi sintetik i fekonditetit arriti në nivele shumë të ulëta. Rastet më ekstreme janë ato të Bullgarisë (1,09 fëmijë për grua) dhe të Republikës Çeke (1,13 fëmijë për

grua), për pjesën tjetër të vendeve të Evropës Lindore ISF arriti minimumin, rreth vlerës 1,2 lindje për grua. Në hipotezën e lindshmërisë së ulët mendohet që ISF e Shqipërisë do të arrijë nivelin 1,2 në vitin 2031 dhe ndoshta më pas të fillojë recuperimin e lindshmërisë.

Fig. 2 ISF nga projeksionet 2011 – 2018 dhe ISF nga projeksionet 2019 – 2031



Hipotezat e Vdekshmërisë

Megjithëse ndryshimet në vdekshmëri nuk kanë pasur të njëjtin ndikim mbi numrin e popullsisë dhe strukturën e saj sa komponentët e tjerë demografikë, në kuadër të përditësimit të projeksioneve janë përditësuar edhe këto hipoteza.

Indikatori mbi të cilin janë hartuar hipotezat e përditësimit të projeksioneve të popullsisë është jetëgjatësia në lindje. Jetëgjatësia në lindje varet nga gjinia sepse natyrisht gratë kanë gjithmonë jetëgjatësi në lindje më të lartë se burrat. Prandaj hipotezat për këtë indikator janë ndërtuar veçmas për secilën gjini.

Të tria hipotezat projektojnë rritjen e jetëgjatësisë në lindje, por me ritme të ndryshme sipas varianteve. Jetëgjatësia e burrave paraqitet që tani në nivele të larta (77,4 në vitin 2018) kështu që ritmi i rritjes së saj është projektuar të jetë më i ulët se ai i grave.

Vdekshmëria e ulët (Jetëgjatësia në lindje e lartë).

Në hipotezën e vdekshmërisë së ulët, jetëgjatësia në lindje projektohet të arrijë në vitin 2031 afërsisht në nivelet e shfaqura në vitet e fundit, si për gratë ashtu edhe për burrat, nga vendet me jetëgjatësinë më të lartë në Europë si Italia, Greqia, Spanja, Zvicra, etj. Në hipotezën e vdekshmërisë së ulët jetëgjatësia në lindje e burrave mendohet të arrijë në 81,5 vite, ndërsa ajo e grave në 85 vite.

Vdekshmëria e mesme

Në hipotezën e mesme të vdekshmërisë supozohet se jetëgjatësia në lindje e grave do të arrijë në vitin 2031 në 83,5 vite, afërsisht sa mesatarja e Bashkimit Europian. Ritmi i rritjes së këtij treguesi për burrat do të jetë pak më i ulët se ai i grave. Si rrjedhojë, në vitin 2031 jetëgjatësia në lindje për burrat supozohet të jetë 80 vite. Ky nivel është më i lartë se mesatarja e Bashkimit Europian pasi burrat në Shqipëri paraqesin që tani nivele të larta të jetëgjatësisë në lindje, sidomos në qoftë se krahasohet me rajonin.

Vdekshmëria e lartë (Jetëgjatësia në lindje e ulët)

Në hipotezën e vdekshmërisë së lartë, supozohet se jetëgjatësia në lindje do të rritet me ritme shumë të ngadalta për periudhën në vazhdim si për burrat ashtu edhe për gratë. Jetëgjatësia në lindje e burrave parashikohet të rritet nga 77,4 vite në 2018, deri në 78,5 vite në 2031. Pra me 1,1 vite përgjatë periudhës 13-vjeçare 2018 – 2031. Edhe jetëgjatësia në lindje e grave parashikohet të rritet me ritme të ngjashme, nga 80,5 vite në 2018, deri në 82 vite në 2031. Pra me 1,5 vite përgjatë periudhës 13-vjeçare 2018 – 2031. Në tabelën e mëposhtme jepen vlerat e projektuara të jetëgjatësisë në lindje për secilën nga hipotezat për vitet 2018, 2021, 2026 dhe 2031.

Tab.1 Hipotezate jetëgjatësisë në lindje (e0) për burrat

| | 2018 | 2021 | 2026 | 2031 |
|------------|------|------|------|------|
| e0 e lartë | 77,4 | 78,3 | 79,9 | 81,5 |
| e0 e mesme | 77,4 | 78,0 | 79,0 | 80,0 |
| e0 e ulët | 77,4 | 77,6 | 78,1 | 78,5 |

Tab.2 Hipotezate jetëgjatësisë në lindje (e0) për gratë

| | 2018 | 2021 | 2026 | 2031 |
|------------|------|------|------|------|
| e0 e lartë | 80,5 | 81,6 | 83,3 | 85 |
| e0 e mesme | 80,5 | 81,2 | 82,4 | 83,5 |
| e0 e ulët | 80,5 | 80,9 | 81,4 | 82 |

Hipotezat e emigracionit

Indikatori i përdorur për ndërtimin e hipotezave të emigrimit është indeksi sintetik i migrimit, i cili paraqet shumën e normave specifike të emigrimit dhe llogaritet sipas gjinisë. Gjatë periudhës 2011 – 2018 ky indeks ndryshe nga parashikimet vazhdoi të rritej për burrat, nga 1,45 në 2011, deri në 1,6 në 2018. Në të njëjtën kohë, indeksi sintetik i migrimit për gratë pësoi një rënie domethënëse gjatë së njëjtës periudhë, nga 1,47 në 2011 deri në 0,35 në 2018. Këto ndryshime në sjelljet migratore të burrave dhe grave, megjithëse prodhojnë një numër gjithsej emigrantësh i cili është në përputhje me atë që sugjerojnë projeksionet e popullsisë 2011 – 2031, kanë ndryshuar në mënyrë domethënëse

përbërjen gjinore të tyre. Në projeksionet e përditësuara janë mbajtur të njëjtat shpërndarje moshore të përdorura në projeksionet e mëparshme për emigrantët, pasi nuk janë vënë re ndryshime domethënëse në këtë aspekt.

Hipotezat e emigrimit për burrat

Për ndërtimin e hipotezave të emigrimit për burrat, u vendos që në variantin e mesëm të tyre indeksi sintetik i migrimit të arrinte në nivelet e parashikuara nga hipoteza e emigrimit të lartë në projeksionet e popullsisë 2011 – 2031. Kjo do të thotë që në variantin e mesëm ISM për burrat do të arrijë sipas një funksioni linear nga 1,6 në vitin 2018, në 1,1 në vitin 2031. Me anë të të njëjtit lloj funksioni vlera e ISM në variantin e ulët mendohet të arrijë 0,7 në vitin 2031, ndërsa në variantin e lartë supozohet të arrijë vlerën 1,5. Këto hipoteza tregohen të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.

Tab.3 Hipotezate emigrimit (ISM) për burrat

| | 2018 | 2021 | 2026 | 2031 |
|-----------------|------|------|------|------|
| Emigrim i lartë | 1,6 | 1,58 | 1,54 | 1,5 |
| Emigrim i mesëm | 1,6 | 1,52 | 1,31 | 1,1 |
| Emigrim i ulët | 1,6 | 1,45 | 1,1 | 0,7 |

Hipotezat e emigrimit për gratë

Për ndërtimin e hipotezave të emigrimit për gratë, u vendos që në variantin e mesëm të tyre indeksi sintetik i migrimit të arrinte në nivelet e parashikuara nga hipoteza e emigrimit të ulët në projeksionet e popullsisë 2011 – 2031. Kjo do të thotë që në variantin e mesëm ISM për gratë do të arrijë sipas një funksioni linear nga 0,35 në vitin 2018, në 0,5 në vitin 2031. Me anë të të njëjtit lloj funksioni, vlera e ISM në variantin e ulët mendohet të arrijë 0,2 në vitin 2031, ndërsa në variantin e lartë supozohet të arrijë vlerën 0,8. Këto hipoteza tregohen të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.

Tab.4 Hipotezate emigrimit (ISM) për gratë

| | 2018 | 2021 | 2026 | 2031 |
|-----------------|------|------|------|------|
| Emigrim i lartë | 0,35 | 0,43 | 0,61 | 0,8 |
| Emigrim i mesëm | 0,35 | 0,38 | 0,44 | 0,5 |
| Emigrim i ulët | 0,35 | 0,33 | 0,26 | 0,2 |

Hipotezat e imigrimit

Gjatë tre viteve të fundit, 2016 – 2018, në Shqipëri kanë imigruar mesatarisht rreth 16,7 mijë burra dhe 7,2 mijë gra. Megjithëse shpërndarja moshore dhe gjinore e tyre nuk kanë pasur ndryshime domethënëse, numri gjithsej i imigrantëve të të dy gjinive rezulton më i lartë se ai i projektuar në variantin e mesëm të projeksioneve të popullsisë 2011 – 2031. Në projeksionet e popullsisë 2011 – 2031 supozohej se rreth vitit 2021 numri i imigrantëve të të dy gjinive do të stabilizohej në nivele të ndryshme sipas varianteve. Për të pasqyruar trendet e reja të numrit të imigrantëve, në përditësimin e

projeksioneve u supozua që numri i tyre do të stabilizohet 5 vite më vonë, pra në vitin 2026, në të njëjtat nivele si më parë për të dy gjinitë. Hipotezat e imigrimit përmbledhen në tabelat e mëposhtme.

Tab.5 Hipotezate imigrimit (numri i imigrantëve) për burrat (në mijë)

| | 2018 | 2021 | 2026 | 2031 |
|-----------------|-------|------|------|------|
| Imigrim i lartë | 16,7* | 14,2 | 8 | 8 |
| Emigrim i mesëm | 16,7* | 13,6 | 6 | 6 |
| Emigrim i ulët | 16,7* | 13,4 | 5 | 5 |

Tab.6 Hipotezate imigrimit (numri i imigrantëve) për gratë (në mijë)

| | 2018 | 2021 | 2026 | 2031 |
|-----------------|------|------|------|------|
| Imigrim i lartë | 7,2* | 6,9 | 6 | 6 |
| Emigrim i mesëm | 7,2* | 6,3 | 4 | 4 |
| Emigrim i ulët | 7,2* | 6 | 3 | 3 |


Hipotezat e projeksioneve rajonale

Ndryshimet demografike të vrojtuar gjatë periudhës 2011 – 2018 në të gjithë vendin kanë ndodhur proporcionalisht në mënyrë të barabartë për të gjithë qarqet. Kjo do të thotë se rënia e ndjeshme e normave të lindshmërisë ka prekur pothuajse njësoj të gjitha qarqet e vendit. Gjithashtu, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për diferencat gjinore në emigrim, e cila është arsyeja tjetër kryesore e përditësimit të projeksioneve. Gjatë viteve 2011 – 2018 lëvizjet e brendshme dhe tendenca e migrantëve të brendshëm për t'u përqendruar kryesisht në qarqet me shkallë të lartë urbanizimi kanë qenë në të njëjtën linjë me ato të parashikuara nga projeksionet e popullsisë 2011 – 2031. Prandaj u pa e arsyeshme që hipotezat mbi lëvizjet e brendshme të mos ndryshonin nga ato të projeksioneve të popullsisë 2011 – 2031. Megjithatë, ndryshimet që rezultojnë nga përditësimi i popullsisë në nivel vendi janë pasqyruar edhe në popullsinë e qarqeve. Për këtë janë ruajtur peshat që zë secili qark në popullsinë e disagreguar sipas gjinisë dhe grupmoshës dhe në të njëjtën kohë është ruajtur edhe numri gjithsej i popullsisë për secilën gjini dhe grupmoshë në rang vendi. Ashtu si edhe në projeksionet 2011 – 2031, skenari i rajonalizuar i projeksioneve të popullsisë është prodhuar në bazë të skenarit të rritjes së mesme. Gjithashtu, në të njëjtën mënyrë si më parë, projeksionet e popullsisë së qarqeve janë prodhuar sipas gjinisë dhe grupmoshave 5-vjeçare dhe për të njëjtat periudha 5-vjeçare si në projeksionet e mëparshme. Pra këtë radhë janë përditësuar rezultatet për të gjitha qarqet sipas gjinisë dhe grupmoshave për vitet 2021, 2026 dhe 2031.

Rezultatet e projeksioneve të përditësuara të popullsisë 2019 – 2031


Skenari i rritjes së mesme të projeksioneve të përditësuara të popullsisë sugjeron që popullsia e Shqipërisë do të tkurret nga 2.862.427 në vitin 2019 në rreth 2.745.996 në vitin 2031. Ky skenar bazohet në hipotezat e mesme të lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migracionit. Në rast se lindshmëria fillon të rekuperohet me shpejtësi nga niveli aktual dhe emigrimi pëson rënie me ritme të larta atëherë popullsia e Shqipërisë pritet që sipas skenarit të rritjes së lartë të arrijë në 2.922.749 banorë në vitin 2031. Ndërkohë që sipas skenarit të rritjes së ulët, ku supozohet rënie e mëtejshme e lindshmërisë dhe rritje të numrit të emigrantëve, popullsia e Shqipërisë pritet të arrijë në 2.592.976 banorë në vitin 2031.

Fig. 3 Projeksionet e përditësuara të popullsisë sipas 3 skenarëve 2019–2031




Sipas skenarit të rritjes së mesme, rritja natyrore ose diferenca ndërmjet numrit të lindjeve dhe vdekjeve, pritet të zvogëlohet nga 8,5 mijë në 2019 në rreth 3,2 mijë në vitin 2031. Përgjatë 5 viteve të para të periudhës së projektuar, rritja natyrore qëndron në nivelet mbi 8 mijë, por më pas zvogëlohet me ritme më të shpejta, nga 8 mijë në 3,2 mijë përgjatë periudhës 2024 – 2031. Sipas skenarit të rritjes së lartë, sugjerohet që rritja natyrore do të arrijë në rreth 13,4 mijë në vitin 2031. Nga ana tjetër, sipas skenarit të rritjes së ulët, rritja natyrore projektohet të kthehet në negative në vitin 2026 dhe të arrijë një nivel minimal prej rreth -6,2 mijë.

Fig. 4 Rritja natyrore e popullsisë sipas 3 skenarëve të projeksioneve të përditësuara të popullsisë, 2019 – 2031




Krahasimi i piramidave të popullsisë për vitin 2019 dhe popullsisë të projektuar të vitit 2031 na tregon se popullsia e Shqipërisë përveçse do të ndryshojë në numër, do të ndryshojë dukshëm edhe përbërjen e saj moshore dhe gjinore. Në figurën e mëposhtme shihet qartë rritja e numrit të popullsisë për moshat e vjetra mbi 65 vjeç, ndërsa moshat nën 65 vjeç në përgjithësi pësojnë tkurrje. Kjo ndodh për të dy gjinitë. Në të njëjtën kohë, nga krahasimi i këtyre piramidave vihet re edhe kalimi nga një popullsi ku popullsitë e burrave dhe grave janë pothuajse të barabarta, në një popullsi ku gratë janë dukshëm më shumë se burrat. Raporti gjinor në popullsinë e 1 Janarit 2019 është 99,8 burra për çdo 100 gra dhe sipas skenarit të rritjes së mesme pritet të arrijë në 89.1 burra për 100 gra në vitin 2031.

Fig. 5 Piramidat e popullsisë sipas projeksioneve të përditësuara të popullsisë, 2019-2031.




Skenari i mesëm i projeksioneve të përditësuara sugjeron që popullsia e Shqipërisë do të vazhdojë procesin e plakjes. Moshë medianë e popullsisë do të rritet nga 36,7 në vitin 2019, në 42,1 në vitin 2031, duke iu afruar ndjeshëm nivelit aktual të vendeve të Bashkimit Evropian prej 42,8 në vitin 2017. Gjithashtu, siç mund të vihet re edhe në grafikun e mëposhtëm, sipas skenarit të mesëm Koeficienti i Varësisë së të Moshuarve (KVM) pritet të rritet nga 20,5 të moshuar për çdo 100 banorë në moshë pune në vitin 2019, në 35,0 të moshuar për 100 banorë në moshë pune në vitin 2031. Në të njëjtën kohë Koeficienti i Varësisë së të Rinjve pritet të qëndrojë në nivele konstante prej rreth 25,0 të rinj për 100 banorë në moshë pune përgjatë gjithë periudhës 2019 – 2031.

Fig. 6 Evoluimi i koeficientëve të varësisë sipas skenarit të mesëm të projeksioneve të përditësuara të popullsisë, 2019 - 2031



Ashtu si edhe në projeksionet e kaluara, versioni i rritjes së mesme është shtrirë deri në vitin 2061, duke mbajtur konstant treguesit e secilës prej hipotezave, në nivelet që ato pritet të arrijnë në vitin 2031. Duke pasur parasysh kontekstin demografik dinamik të Shqipërisë, shtrirja e çdo projekcioni vlerësues përtej periudhës prej 20 vitesh është një ushtrim i rrezikshëm. Skenari i rritjes së mesme deri në vitin 2061 duhet të trajtohet me kujdes dhe të interpretohet si një tregues i përafërt i një tendence të mundshme. Rezultatet e parashikimit tregojnë një intensifikim të rënies së popullsisë pas vitit 2031 për të arritur në 2,1 milionë banorë në vitin 2061 (Figura 7). Popullsia në moshë pune do të pësojë rënie për të arritur në më pak se 1,2 milionë. Popullsia e të rinjve (0-14 vjeç) pritet të pësojë rënie të vazhdueshme deri në rreth 283.000 në vitin 2061, ndërsa numri i të moshuarve pritet të stabilizohet mbi 630.000 në fund të periudhës së projektimit. Siç edhe mund të vihet re, ndryshime të tilla të popullsisë do të sillnin si rezultat një popullsi shumë të plakur, ku moshë medianë mendohet të jetë 49,7 vjeç.


Fig. 7 Tendanca e numrit gjithsej të popullsisë, popullsisë në moshë pune, të rinjve dhe të moshuarve, 2019 – 2061



Sipas projeksioneve të përditësuara 2019 – 2031 vihet re se i vetmi qark, popullsia e të cilit do të rritet gjatë periudhës 2019 – 2031, është Tirana. Kjo rritje pritet të jetë sa 6,6 % e popullsisë së Tiranës në vitin 2019. Në vitin 2031, popullsia e qarkut të Tiranës pritet të përbëjë rreth 35 % të popullsisë së Shqipërisë me rreth 954 mijë banorë.

Popullsia e të gjitha qarqeve të tjera të Shqipërisë pritet të zvogëlohet. Popullsia e Qarkut të Kukësit dhe ajo e Qarkut të Dibrës pritet të zvogëlohen deri në vitin 2031 me mbi 20 % të popullsisë së tyre të vitit 2019. Ndërkohë që popullsia në vitin 2031 në qarqet e Beratit, Elbasanit, Fierit dhe Gjirokastrës pritet të zvogëlohet me nga 10 % - 14 % të popullsisë respektive në vitin 2019. Qarku me numrin më të vogël të popullsisë do të vazhdojë të jetë Gjirokastra me rreth 52 mijë banorë në vitin 2031, i ndjekur nga Kukësi dhe Dibra, respektivisht me rreth 60 mijë dhe 94 mijë banorë.

Fig. 8 Ndryshimi i popullsisë së qarqeve sipas projeksioneve të popullsisë, 2019 – 2031



Metodologjia

Metoda e komponentit të gjeneratës

Për të llogaritur projeksionet e popullsisë, ekzistojnë 3 skenare të mundshme të cilat bazohen në vlerësimin e trendeve të ardhshme të lindjeve, vdekjeve dhe migracionit. Duke qenë se nuk mund të parashikohen saktë këto fenomene për të ardhmen, përgatiten tri variante, ai i ulët, i mesëm dhe i lartë. Varianti i mesëm konsiderohet dhe varianti më i mundshëm.

Ndryshimi demografik ndodh kur çiftet linden fëmijë dhe kur individët vijnë nga vende të tjera duke shtuar individë të rinj në popullsi, ndërsa të tjerë vdesin apo largohen në vende të tjera, duke e zvogëluar popullsinë. Për shkak se këto ngjarje demografike ndikojnë tek popullsia sipas gjinisë dhe grupmoshave të ndryshme, ato përcaktojnë numrin dhe strukturën e saj. Objektivi kryesor i projeksioneve demografike është përcaktimi se si lindjet, vdekjet dhe migrimet do të ndodhin në vitin pasues. Metodologjia e përdorur për këtë cikël të projeksioneve të popullsisë nga INSTAT-i, modeli i komponentit të brezave përlllogarit këto ngjarje për secilin vit, gjini apo moshë sipas supozimeve të tendencave të besueshme të vdekshmërisë, lindshmërisë dhe migrimit në të ardhmen. Këto ngjarje i zbriten dhe i shtohen popullsisë në fillim të vitit, duke dhënë popullsinë sipas moshës dhe gjinisë në fillim të vitit pasues, e kështu me radhë.

Numri i ngjarjeve demografike varet nga struktura e popullsisë edhe nga sjellja demografike (d.m.th numri i lindjeve varet nga numri i grave në moshën riprodhuese dhe koeficientët specifikë të lindshmërisë). Meqenëse struktura e popullsisë dhe sjelljet demografike njihen për vitin bazë, tendencat e ardhshme në sjelljen demografike u parashikuan bazuar në hipotezat që mbështeten në njohuritë tona të situatës demografike, tendencat e kaluara, konteksti politik dhe social ekonomik, dhe krahasimet ndërkombëtare.

Popullsia sipas grupmoshës dhe gjinisë në fillim të projeksioneve, 1 Janar 2019, është vlerësuar nga INSTAT në bazë të të dhënave empirike të viteve paraardhëse.

Popullsia në nivel kombëtar, sipas gjinisë dhe moshës projektohet në mënyrë të përsëritur vit pas viti, duke filluar me popullsinë në 1 Janar, si më poshtë:

- Numri i vdekjeve vlerësohet për gjashtë muajt e parë nga aplikimi i normave të vdekshmërisë sipas moshës dhe gjinisë për popullsinë në 1 Janar; vdekjet zbriten nga popullsia për të përfutur të mbijetuarit në mes të vitit (30 Qershor);
- Numri i vjetor i emigrantëve sipas grupmoshës dhe gjinisë vlerësohet nga popullsia në mes të vitit duke përdorur normat e emigrimit dhe këto ngjarje më pas zbriten; ndërkohë numri i supozuar i imigrantëve sipas gjinisë rishpërndahet sipas moshës dhe i shtohet popullsisë.
- Numri i vdekjeve për gjysmën e dytë të vitit vlerësohet dhe zbritet nga ky numër i rishikuar i popullsisë në mes të vitit, duke dhënë numrin e të mbijetuarve në 31 Dhjetor;
- Numri i lindjeve vlerësohet duke shumëzuar normat e lindshmërisë sipas grupmoshave me numrin mesatar të grave në moshë riprodhimi; vdekjet e foshnjave dhe ato që emigrojnë deri në fund të vitit vlerësohen dhe zbriten nga numri i lindjeve;

- Për të projektuar popullsinë në 1 Janar të vitit pasues, secili grup çohet përpara me një vit në moshë, për të reflektuar plakjen e popullsisë dhe numri i lindjeve mbijetuese brenda vendit përbën moshën e parë (mosha 0).

Popullsia e qarqeve sipas gjinisë dhe grupmoshave 5 vjeçare projektohet në mënyrë të përsëritur dhe njëkohësisht në intervale pesë vjeçare duke përdorur një model shumërajonal të rezervës së migrimit të komponentit të brezave, i cili u përshtat nga modeli shumë rajonal i propozuar nga Kombet e Bashkuara (OKB, Kombet e Bashkuara 1992). Procedura përmban hapat e mëposhtëm për secilin qark:

- Popullsia sipas gjinisë dhe moshës në fillim të intervalit projektohet të mbijetojë me 5 vjet.
- Emigrantët mbijetues (jashtë vendit) dhe emigrantët brenda vendit (në qarqe të tjera) vlerësohen njëri pas tjetrit duke përdorur normat e tranzicionit për migrantët (pasi është marrë parasysh vdekshmëria dhe migrimin ndërkombëtar në rastin e emigrimit brenda vendit), që zbatohen për popullsinë në fund të intervalit. Emigrantët i zbriten numrit të popullsisë dhe emigrantët brenda vendit shpërndahen sipas grupmoshës dhe gjinisë, duke dhënë numrin e imigrantëve brenda vendit për rishpërndarje.
- Numri i imigrantëve brenda vendit, si dhe një numër i supozuar i imigrantëve (nga parashikimi në nivel kombëtar) i shtohen popullsisë në fund.
- Lindjet vlerësohen duke i aplikuar normat specifike të lindshmërisë popullsisë mesatare në fillim dhe në fund të intervalit 5 vjeçar dhe projektohen të mbijetuarit deri në fund të intervalit.
- Për të përfutur popullsinë në 1 Janar në fillim të intervalit pasues 5 vjeçar, secili brez çohet përpara me pesë vjet në moshë për të reflektuar plakjen e popullsisë; numri i lindjeve të gjalla brenda Shqipërisë përbën grupmoshën e parë.
- Popullsia sipas gjinisë dhe moshës dhe ngjarjet demografike në nivel qarku duhet që të përkohet me totalin e përcaktuar nga projeksionet kombëtare.

Përkufizime

Popullsia banuese: bazohet në konceptin e vendbanimit të zakonshëm. Sipas këtij përkufizimi përfshihen në popullsinë banuese të një viti, të gjithë ata persona që banojnë ose kanë si qëllim të banojnë në vend për të paktën 12 muaj, pavarësisht shtetësisë së tyre.

Mosha medianë: është mosha në të cilën gjysma e popullsisë është më e vjetër dhe gjysma më e re.

Raporti gjinor: është raporti i burrave ndaj grave në një periudhë të dhënë, zakonisht i shprehur si numri i burrave për çdo 100 gra.

Raporti gjinor në lindje: është raporti i numrit të bebeve djem ndaj numrit të bebeve vajza në një periudhë të dhënë, zakonisht i shprehur si numri i bebeve djem për çdo 100 bebe vajza.

Shtesa natyrore e popullsisë: Është teprica (ose deficiti) i lindjeve ndaj vdekjeve në një popullsi në një periudhë kohe të dhënë (L-V).

Migracioni neto: Është teprica (ose deficioni) i imigrantëve ndaj emigrantëve në një popullsi në një periudhë kohe të dhënë (I-E).

Raporti i varësisë së të rinjve: Është raporti i personave në moshë 0-14 vjeç ndaj popullsisë në moshë pune 15-64 vjeç.

Raporti i varësisë së të moshuarve: Është raporti i personave në moshë 65+ vjeç ndaj popullsisë në moshë pune 15-64 vjeç.

Indeksi Sintetik i migrimit (ISM): Numri mesatar i migrimeve që një brez hipotetik individësh do të provonin deri në fund të jetës së tyre nëse do të ishin subjekt gjatë të gjithë jetës, i shkallës së migrimit në një periudhë të caktuar kohe (dhe nëse nuk janë subjekt i vdekshmërisë). Shprehet si migrime për çdo individ.

Jetëgjatësia në lindje (e0): Numri mesatar i viteve të jetës i pritshëm për një grup hipotetik individësh, të cilët gjatë gjithë jetës së tyre do të jenë subjekt i normave specifike të vdekshmërisë të një periudhe të caktuar. Shprehet me vite.

Indeksi Sintetik i Fekonditetit (ISF): Numri mesatar i fëmijëve që një grup hipotetik grash do të ketë në fund të periudhës së tyre riprodhuese nëse ato do të ishin subjekt i koeficientëve specifike të lindshmërisë së një periudhe të dhënë. Shprehet në fëmijë për grua.